

V E N D I M
Nr.184, datë 4.5.1994

**PËR DHËNIEN E KOMPENSIMIT PASUROR ISH-TË DËNUARVE DHE TË
PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST**

Në zbatim të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, nenet 7,8,9,11 dhe 13, me propozimin e Ministrisë së Financave, Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Kompensimi pasuror i ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, në zbatim të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, do të bëhet kryesisht me letra me vlerë, sipas formës dhe mënyrës së përdorimit të tyre të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.504, datë 18.10.1993 “Për emetimin e obligacioneve shtetërore për kompensimin e ish-pronarëve dhe të përndjekurve politikë”.

Rastet e përjashtimit nga forma e kompensimit me letra me vlerë përcaktohet në këtë vendim.

2. Të gjithë ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë që kanë përfituar të drejtën e kompensimit pasuror sipas ligjit “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, në zbatim të neneve 7 dhe 9, përfitojnë në formën e letrave me vlerë një kompensim vjetor prej 120.000 lekë.

Për efekt llogaritjeje viti kalendarik do të merret me 365 ditë.

3. Të gjithë ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, të përcaktuar në nenin 3, shkronja “b” e ligjit “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” që:

a) Kanë bërë më shumë se 10 vjet heqje lirie dhe në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi kanë mbushur moshën 50 vjeç, me dëshirën e tyre, për ditët që janë mbi këtë masë vuajtjeje dënimi, mund t’u kthehen në të holla por jo më shumë se 200 000 lekë.

b) Kanë bërë më shumë se 20 vjet heqje lirie, me dëshirën e tyre, pavarësisht nga mosha, për ditët që janë mbi këtë masë vuajtjeje dënimi mund t’u kthehen në të holla, por jo më shumë se 250 000 lekë.

c) Në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi vërtetohen me raport mjekoligjor se janë invalidë të grupit të parë dhe të dytë, me dëshirën e tyre, mund të kompensohen me para në dorë, por jo më shumë se 300 000 lekë.

ç) Në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi kanë mbushur moshën 55 vjeç, me dëshirën e tyre, pavarësisht nga masa e dënimit të vuajtur, mund t’u kthehet në të holla një pjesë e kompensimit që u takon, por jo më shumë se 100 000 lekë.

d) Të gjitha gratë, pavarësisht nga mosha ose masa e vuajtjes së dënimit, me dëshirën e tyre, mund të kompensohen me para në dorë, por jo më shumë se 200 000 lekë. Në rast se ato plotësojnë një nga kushtet e shkronjave “b” dhe “c” të kësaj pike, kanë të drejtë të zgjedhin vlerën e kompensimit të njërës prej tyre.

4. Nga të drejtat që burojnë nga pika 3 e mësipërme, përfitojnë vetëm personat që jetojnë në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Të gjithë ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë të përcaktuar në nenin 3, shkronja “a” e ligjit “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, në bazë të së drejtës që lind nga neni 8 i këtij ligji për një shpërblim të menjëhershëm në të holla, ata ose trashëgimtarët e tyre të ligjshëm, do të marrin një shpërblim prej 200 000 lekë.

6. Personat që përfitojnë të drejtën ta marrin në të holla një pjesë të kompensimit sipas masës dhe kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, e gëzojnë këtë të drejtë vetëm një herë.

7. Të gjithë ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë që do të përfitojnë letra me vlerë për efekte të ligjit “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, mund të marrin pjesë pa ankand në procesin e privatizimit të pronës shtetërore. Çdo ish-i dënuar dhe i përndjekur politik që do të disponojë letra të tilla, është i lirë t’i shesë, depozitojë a këmbejë lirisht në të gjitha format që përcakton ligji.

8. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga zëri i buxhetit të shtetit “Shpenzime për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë”. Në rast se shuma e kompensimit me para në dorë do të rezultojë më e madhe se ajo e parashikuar në buxhet për këtë qëllim, kompensimi do të shtyhet në vitet e ardhshme sipas mundësive që do të paraqesë buxheti i shtetit i çdo viti. Në këtë rast, të gjithëve atyre që dëshirojnë, u njihet e drejtë të marrin këtë shumë në formën e letrave me vlerë brenda vitit 1994 sipas kritereve të këtij vendimi.

9. Komisioni Përgatitor i Procesit të Privatizimit në Ministrinë e Financave, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, ngarkohen që brenda muajit maj të vitit 1994 të paraqesin në Këshillin e Ministrave projektvendimin për privatizimin me letra me vlerë kompensimi.

10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Komiteti i ish-të Përndjekurve Politikë dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi